

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2282 Prot

Durrës, më: 8.10.2025

V E N D I M

Nr. 109, datë 8.10 2025

PËR

**"PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE
PËR MANDAT PLOTËSUES TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ) NË
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës" miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 29, datë 29.03.2024; si dhe referuar kërkesës për dorëheqje nga detyra si anëtar i KIZ, përfaqësues i studentëve me nr. 2219 prot., datë 30.09.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtarë përfaqësues të studentëve për mandat plotësues të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët për anëtarë përfaqësues të studentëve për mandat plotësues të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në UAMD vetëkandidohen dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim, (bashkëlidhur), shoqëruar nga të paktën 30 firma të studentëve që mbështesin kandidaturën;
 - b) Vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore (formulari bashkëlidhur);
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
3. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data **13.10.2025 deri në datën 17.10.2025, ora 9:00 - 14:00**, pranë sekretarisë së Senatit Akademik, zyra 302, Currila.
4. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, Sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat e studentëve që aplikojnë me Kryesekretaritë e Fakulteteve përkatëse, përcjell listën për votim në Senatin Akademik.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - ✓ Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për publikim në faqen zyrtare
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



Durrës, më ____ / ____ /2025

FORMULAR APLIKIMI
PËR ANËTAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE

Unë i/e nënshkruar/a _____ lindur
më ____ / ____ / ____ në _____ student në vitin _____ dega _____
Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të qenë anëtar i Komisionit
Institucional të Zgjedhjeve.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lire se jam :

☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim : Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale ne vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22. 07. 1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.